

URDHËR
Nr. 219, datë 19.4.2021

PËR KARANTINIMIN E PERSONAVE QË VIJNË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË NGA REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT DHE GREQIA

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 1, germa “c”, të ligjit nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, si dhe në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 1892 datë 19.4.2021, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës,

URDHËROJ:

1. Vetëkarantinimin e detyrueshëm, për një periudhë 14-ditore, për të gjithë shtetasit që hyjnë në Republikën e Shqipërisë përmes rrugëve ajrore, tokësore ose detare nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia, nga data 20.4.2021 deri në datën 3.5.2021.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri organet kompetente për dhënien e masave administrative sipas aktit normativ nr. 3, datë 15.3.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së shkaktuar nga COVID-19”, i ndryshuar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu